



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:027860

Datë: 22.07.2024

Numri i dokumentit: 05963307

P.nr.2024:027860

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkpuntorin profesional Afrim Gashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.A nga fshati Brestoc, me vendbanim në Gjakovë, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1498/2024 të datës 24.01.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 15.07.2024, në prezencën e Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj, si dhe të akuzuarit, në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

A.A i lindur me dt..... në fsh.Brestoc, K. Rahovec, në Gjakovë nga i ati I e ëma S e vajzërisë K, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, pensionit Veteran i UCK-së, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 09.10.2023, rreth orës 16:40, në fsh.Brestoc, K. Rahovec, i pandehuri duke vepruar në kundërshtim me nenin 4 par.1 të Ligjit Për Armë Nr.05/L-022 pa autorizim ka mbajtur në pronësi armë, në atë që mënyrë ditën kritike me rastin e bastisjes në shtëpinë e të pandehurit është gjetur dhe sekuestruar një pushkë automatike AK-47, me nr. serik 047715-87 se bashku me dy karikator dhe 26 fishek të kalibrit 7.62 x 39mm, për të cilat i pandehuri nuk ka pasur leje apo autorizim për posedim

- Me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40 par.1 nënpar.1.3, 43, 69, 70 dhe nenit 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të njëjtit;

E G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumën prej **tetëqind (800) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pasi që Aktgjykimi të merrë formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësojë me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **katërdhjet (40) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **njëzet (20) euro, të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I SHQIPTOHET – dënimi plotësues, konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, që të pandehurit t'i konfiskohet një pushkë automatike AK-47, me nr. serik 047715-87 se bashku me dy karikator dhe 26 fishek të kalibrit 7.62 x 39mm.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1498/2024 të datës 24.01.2024, kundër të akzuarit A.A nga fshati Brestovc, me vendbanim në Gjakovë, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 15.07.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj dhe i akuzuari.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i cili ka qëndruar në tërësi pranë saj, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë, si dhe gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

I akuzuari deklaroi se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur, pendohet për veprimin e bërë, i premtonte gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, mirëpo mëse e vërteta është se këtë armë e kam mbajtur si suvenir prej Luftës pasi që vetë e kam marrë

në Shqipëri dhe kurrë nuk është përdor për azgjë, i propozon gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit, pasi që është hera e parë që ndeshem me ligjin dhe i gjendjes së mesme ekonomike.

Prokurori i shtetit jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë i cili deklaron se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favorët dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ngarkohet i akuzuari. I propozoj gjykatës që i akuzuar të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet një dënim të paraparë ligjor duke pasur parasysh shkallen e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit të ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë në këtë shqyrtim fillestar, pendimin e tij, premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër penale ndërsa si rrethana rëndësues ia lë në vlerësim gjykatës.

Gjykata konform dispozitave të nenit 364 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 241 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari Agim Arllati, me dashje ka kryer veprën mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen "**Kushdo që mban në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatmijë e pesëqind (7.500) euro, ose me burgim deri në pesë (5) vjetë.**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat materiale të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

- Raporti i policit A.B, dt.09.10.2023;
- Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, dt. 09.10.2023
- Deklarata e të pandehurit A.A e dhënë në Prokurori me dt.09.10.2023;
- Procesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesës dt.09.10.2023;

Foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera në lëndë.

Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit, gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me gjobë me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 462 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë, e në vështrim të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.2024:027860, me datë 15.07.2024

Bashkp.Profesional
Afrim Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.